ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: SPITALI I PERGJITHSHEM- PEJË

Nr1 i prokurimit	**70030-24-2814-5-2-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **"RENOVIMI I HAPESIRAVE TË SP (LOT 1- Renovimi i repartit te dializës, dhomat e njësisë koronare të repartit neurologjik dhe hemodializes, reparti i dermatologjisë dhe psikiatrisë si dhe LOT 2- Renovimi i objektit të administratës)".**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit

Valmir Loshi B.I.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Gurakoc

(Adresa)

Istog ***31000***

(Vendi) ***(Kodi postar)***

044-208 136

(Numri Telefonit) ***(Numri i Faks-it)***

Valmir Loshi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

loshi-design@hotmail.com

(Adresa elektronike)

24.04.2024

(Data e parashtrimit të ankesës) ***(Nënshkrimi dhe vula)***

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë me dt. 25.03.2024 Afati i fundit për dorëzimin e ofertave me dt. 19.04.2024 Kërkesat për rishqyrtim: 12.04.2024 Vendimi për aprovim të pjesërishëm të kërkesës për rishqyrtim: 15.04.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 27 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 17.7 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me dt.25.03.2024 është publikuar tenderi me titull **"RENOVIMI I HAPESIRAVE TË SP (LOT 1- Renovimi i repartit te dializës, dhomat e njësisë koronare të repartit neurologjik dhe hemodializes, reparti i dermatologjisë dhe psikiatrisë si dhe LOT 2- Renovimi i objektit të administratës)".** Ne si palë e interesuar për të ofertuar në këtë projekt e kemi analizuar dosjen e tenderit në tërësi dhe njoftimin për kontratë, ndërsa kemi vërejtur se janë vendosur kërkesa diskriminuese/favorizuese në dosje të tenderit, të cilat do ti sqarojmë më poshtë:

Tek kërkesa e nenit 9.1&9.2 FDT-së është kërkuar *"OE Ofertues Për LOT 1- O.E ofertues duhet te dëshmoj se ka Projekte te realizuara (të NJEJTA RENOVIME) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE, minimumi në vlerë 105,000.00 euro, te realizuara para datës se njoftimit për kontrate. Për LOT 2- O.E ofertues duhet te dëshmoj se ka Projekte te realizuara (të NJEJTA RENOVIME) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE, minimumi në vlerë 30,000.00*

euro, te realizuara para datës se njoftimit për kontrate. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të njëjta të realizuara në 3 vitet e fundit", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Projektet e realizuara (të ngjashme) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE, minimumi në vlerë (PËR LOT 1- 105.000.00€ DHE LOT 2- 30,000.00€). Lista e projekteve të realizuara gjatë periudhës tre vjeqare në të cilat specifikohen të gjitha projektet e realizuara në tre vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë duke saktësuar furnizimet e kryera, shumën e kontratës dhe vendin e kryerjes së furnizimeve, bashkangjitur referenca ose çertifikatë ose raporte të pranimit. Projektet e realizuar ne sektorin privat duhet te dëshmohen me pagesat ne banke"*.

Kërkesa e lartcekur e dosjes së tenderit është kërkesë diskriminuese dhe e njëjta kufizon konkurrencën, pasi që nuk mund dhe nuk duhet të kërkohen kontrata të natyrës së njëjtë mirëpo kërkesa duhet të ndryshohet dhe të lejohen të prezantohen kontrata të natyrës së ngjashme, ashtu siç edhe është specifikuar dëshmia e kërkuar dokumentare.

Pra ne kërkojmë që të ndryshohet kërkesa e lartcekur dhe të lejohen të prezantohen kontrata të natyrës së ngjashme ose të njëjtë. **(Ky pretendim i yni është marr parasysh dhe autoriteti kontraktues e ka ndryshuar kërkesën sipas pretendimit tonë ankimor).**

Tek kërkesa tjetër tek neni 9.1&9.2 po ashtu është kërkuar *"LOT 1 OE Ofertues duhet te jete i certifikuar sipas EN- ISO 9001-2015, EN- ISO 14001-2015; EN- ISO 45001-2018; EN- ISO 27001-2013. LOT 2 OE Ofertues duhet te jete i certifikuar sipas ISO 9001 2015 , ISO 14001 2015 dhe ISO 450001 2018 Në rast të konzorciumit Të gjithë anëtarët e konzorciumit duhet të jenë të certifikuar me këto certifikata ISO"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"LOT 1- Certifikatat ISO Origjinal ose kpoje të Noterizuara sipas EN-ISO 9001-2015. EN- ISO 14001-2015; EN- ISO 45001-2018; ISO 27001-2013. LOT 2- Certifikatat ISO Origjinal ose kopje të Noterizuara ISO 9001 2015 , ISO 14001 2015 dhe ISO 450001 2018"*.

Kërkesa e lartcekur e dosjes së tenderit që OE duhet të posedojnë ISO standardet EN- ISO 14001-2015; EN- ISO 45001-2018; ISO 27001-2013, është kërkesë diskriminuese për faktin se këto standarde janë të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit dhe të njëjtat duhet të largohen në tërësi nga dosja e tenderit.

Më poshtë po ju sqarojmë se për çka shërbejnë standardet e lartcekura ku kuptohet qartë se të njëjtat janë të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht kërkesa për këto standarde e kufizon konkurrencën në maksimum.

***EN-ISO 14001:2015**: Ky standard është për menaxhimin e mjedisit. Synimi është të ndihmojë organizatat të zhvillojnë një përgjigje të qëndrueshme ndaj sfidave mjedisore duke përmirësuar performancën mjedisore, kontrolluar ndikimin e tyre në mjedis dhe përmbushur kërkesat ligjore dhe të tjera që lidhen me mjedisin.*

***EN-ISO 45001:2018**: Ky është standardi për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Ai synon të ndihmojë organizatat të përmirësojnë sigurinë dhe shëndetin në punë duke krijuar një ambient pune më të sigurt dhe më të shëndetshëm, duke reduktuar riskun për punonjësit dhe duke përmbushur kërkesat ligjore dhe të tjera në këtë fushë.*

***ISO 27001:2013**: Kjo është një standard për menaxhimin e sigurisë së informacionit. Synon të ndihmojë organizatat të mbrojnë informacionin e tyre të rëndësishëm dhe të përballen me rreziqet e sigurisë së informacionit duke zbatuar një qasje të rregullt dhe të përshtatshme për menaxhimin e sigurisë së informacionit (ISMS).*

Andaj kërkojmë të ndryshohet kërkesa e lartcekur duke u larguar në tërësi kërkesa sa i përket ISO standardeve të lartcekura, pasi që në të kundërtën nëse nuk ndryshohet kërkesa e lartcekur, atëherë një veprim të tillë të AK-së ne nuk mund ta kuptojmë ndryshe përveç se favorizim të hapur ndaj një kompanie e cila i posedon ISO standardet e lartcekura.

Tek kapaciteti teknik dhe profesional, përkatësisht tek kërkesat për personelin për Lot 1 dhe 2 janë vendosur kërkesa diskriminuese dhe të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit, të cilat do ti sqarojmë më poshtë:

LOT 1- "Menaxheri i projektit, duhet të jetë **Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë-drejtimi konstruktiv** ose **Inxhinier i diplomuar i arkitekturës** - 5 vjet përvojë pune pas diplomimit; b. **Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi hidroteknik** - 5 vjet përvojë pune pas diplomimit; **c. Një (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikës** - 5 vjet përvojë pune pas diplomimit; **d. Një (1) inxhinier i diplomuar i makinerise** - 5 vjet përvojë pune pas diplomimit; e. **Një (1) dizajner i enterierit me titull bachelor**-me 4 vite përvojë pune pas diplomimit".

Inxhinierët e lartcekur të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktues janë të panevojshëm për këtë aktivitet të prokurimit dhe të njëjtit duhet të largohen në tërësi nga dosja e tenderit, pasi që me këto kërkesa po kufizohet konkurrenca në maksimum ku po ju pamundësohet ofertimi OE të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht po favorizohet një OE i caktuar (të cilin AK e din shumë mire se për cilin OE bëhet fjalë), i cili i posedon inxhinierët e lartcekur.

SE përse këta inxhinier nuk janë të nevojshëm për këtë aktivitet të prokurimit, mjafton të analizohet paramasa dhe kuptohet qartë se në këtë rast asnjëri prej inxhinierëve të lartcekur nuk mund të kryejnë detyrat për të cilat janë të thirrur dhe këtë fakt po e sqarojmë më poshtë, ku po i sqarojmë detyrat e inxhinierëve:

-**Inxhinieri konstruktiv**-Është një profesionist në fushën e inxhinierisë civile që ka për detyrë projektimin, ndërtimin, dhe mbikëqyrjen e strukturave të ndryshme të ndërtimeve, përfshirë ndërtime të reja, rindërtimin e ndërtimeve ekzistuese, dhe të gjitha aspektet e lidhura me sigurinë dhe integritetin e strukturave të ndërtimeve.

-**Inxhinieri i ndërtimtarisë-drejtimi hidroteknik** ka përgjegjësi specifike në fushën e projektimit, ndërtimit, dhe menaxhimit të projekteve të lidhura me infrastrukturën hidrike.

-**Inxhinieri i diplomuar i elektroteknikës** është një profesionist në fushën e inxhinierisë elektrike i cili ka njohuri dhe aftësi të specializuara në projektimin, zhvillimin, instalimin, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektrike dhe elektronike. (Në këtë aktivitet të prokurimit, janë vetëm tri pozicione që kanë të bëjnë me elektrikën, për të cilat është i panevojshëm inxhinieri, pasi që kemi të bëjmë me montim të prizave, paneleve ndriçuese dhe instalime të thjeshta në mur).

-**Inxhinieri i diplomuar i makinerisë** është një profesionist në fushën e inxhinierisë me njohuri dhe aftësi të specializuara në projektimin, zhvillimin, instalimin, operimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve mekanike dhe makinerike. (Në këtë aktivitet të prokurimit, ky inxhinier nuk nevojitet për asnjë pozicion të paramasës).

- **Dizajneri i enterierit me titullin bachelor** është një profesionist në fushën e dizajnit që ka njohuri dhe aftësi të specializuara në krijimin dhe përmirësimin e ambienteve të brendshme të ndryshme. (Në këtë aktivitet të prokurimit kemi të bëjmë me renovim dhe jo hartim të dizajnit të objektit apo hapësirave të brendshëm, pra edhe dizajneri i enterierit është i panevojshëm për këtë aktivitet të prokurimit).

LOT 2- *"Menagjeri i projektit - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë – (drejtimi konstruktiv, Nje inxhinier i diplomuar ose master i hidroteknikes, Nje inxhinier i diplomuar ose master i makinerisë".*

Ashtu siç edhe e cekëm më lartë për Lot 1 edhe për Lot 2 inxhinierët e lartcekur janë të panevojshëm për këtë aktivitet të prokurimit dhe të njëjtit duhet të largohen në tërësi nga dosja e tenderit. Kërkesat e lartcekura janë kërkesa të cilat po e favorizojnë direkt një OE të caktuar, për të cilën AK-ja e di shumë mirë se për cilën kompani e kemi fjalën, e cila i posedon inxhinierët e lartcekur. Këto kërkesa janë në kundërshtim të plotë me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit dhe punët të cilat do të kryhen, andaj duhet të largohen në tërësi nga dosja e tenderit.

Në dosje të tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar *"Operatorët Ekonomik ofertues duhet të sjellin raportin e vlerësimit të rriskut për të gjitha pozitat e organogramit dhe organizimit të kompanisë nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- jO ME TE VJETER SE 1 VIT"*. Edhe kjo kërkesë është e panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit dhe të njëjtën kërkojmë që të largohet në tërësi nga dosja e tenderit ose të ndryshohet duke u lejuar të prezantohet raporti jo më i vjetër se tri vitet e fundit.

Tek kërkesa tek kapaciteti teknik dhe profesional për Lot 1 dhe 2 është kërkuar *"LOT 1 O.E ofertues duhet të sjellë Listen e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve* ***1 .Kamion Kiper (VETË SHKARKUES) minimim 2 copë;*** *2. Pick UP minimum ose Mjete per bartjen e pajisjeve Punetorve 2 copë. LOT 2 O.E ofertues duhet te kete ne pronesi ose posedim edhe keto paisje* ***1. Kamion me peshe bartese mbi 10 ton;"***, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Deshmia 4. Lista e pasisjeve- mjeteve te punes qe OE duhet te kete te vetat apo te kontraktuara(apo me qira) per aktivitetin ne fjale, te deshmohen me kopje te librezave, deklarate doganore, faktura. Te deshmohet se pajisjet motorike jane te regjistruara dhe kane sigurim valid-Kopja e librezave te paisjeve"*.

Pajisjet si Kamioni kiper 2 copë për Lot 1 dhe Kamioni me peshë bartëse mbi 10 ton për Lot 2 janë pajisjet të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit, pasi që mjafton vetëm të analizohet paramasa e të dyja loteve dhe kuptohet qartë se pajisjet e lartcekura janë të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit.

Këto kërkesa janë kërkesa diskriminuese, favorizuese për OE të caktuar dhe njëkohësisht janë të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit, kur është i qartë fakti se në këtë aktivitet të prokurimit kemi të bëjmë me renovime të natyrës së lehtë. Pra renovimet e parapara në këtë aktivitet të prokurimit mund të përfundohen pa pajisjet e lartcekura, andaj të njëjtat janë të panevojshme dhe duhet të largohen në tërësi nga dosja e tenderit sepse nuk janë në harmoni me natyrën dhe qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Duke pasur parasysh këto fakte atëherë duhet të largohen si kërkesa këto pajisje.

Këto kërkesa shihet qartë se e favorizojnë një OE të caktuar i cili i posedon këto mjete dhe si të tilla këto kërkesa e kufizojnë konkurrencën, pasi që po përcaktohet qysh në fillim fituesi i këtij aktiviteti të prokurimit.
Në këtë rast po favorizohet një kompani e caktuar, për të cilën autoriteti kontraktues e din shumë mirë se për cilën kompani bëhet fjalë, andaj kërkojmë të largohen në tërësi kërkesat e lartcekura, me qëllim të hapjes së konkurrencës.

Tek kapaciteti teknik dhe profesional po ashtu është kërkuar *"LOT 2- Operatori ekonomik duhet te prezantoj stafin Teknik dhe te kualifikuar te cilet duhet te kene kualifikimet shkollore te meposhtme. Nje Teknik I diplomuar I ndertimtarise me se paku dy vite pervoje pune pas diplomimit. Nje Teknik I diplomuar I makineris me se paku dy vite pervoje pune pas diplomimit. Nje parkeshtrues I diplomuar me pervoje pune me se paku dy vite pas diplomimit.Nje Moler I certifikuar apo trajnuar , Nje pllaka shtrues I certifikuar apo trajnuar , nje mjeshter knaufi I certifikuar apo trajnuar"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"LOT 2- Për te gjithë stafin Teknik dhe te kualifikuar te prezantohen diplomat(Diploma*

shkolles se mesme apo diploma profesionale) , certifikata kopje te noterizume. Kontrata e punes apo marreveshja e bashkpunimit. Per tekniket te prezantohen CV dhe referencat. I gjithe stafi professional , tekniket dhe punetoret e kualifikuar duhet te kene se paku trajnim per siguri dhe shendet ne pune dhe trajnim per mbrotje nga zjarri".

Kërkesat e lartcekura për stafin teknik të kërkuar, janë kërkesa diskriminuese dhe të njëjtat duhet të largohen në tërësi nga dosja e tenderit. Kur analizohet paramasa e këtij aktiviteti të prokurimit shihet qartë se teknikët, përvoja dhe kërkesa për trajnim për siguri dhe shëndet në punë dhe trajnim për mbrojtje nga zjarri janë kërkesa të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit. Të njëjtat kërkesa e kufizojnë konkurrencën në maksimum dhe njëkohësisht ju pamundësojnë ofertimin edhe OE me përvojë të madhe në Renovim të objekteve.

Andaj me qëllim që ky aktivitet i prokurimit të zhvillohet në përputhje me dispozitat ligjore të Legjislacionit primar dhe atij sekondar të prokurimit, kërkojmë që të largohen në tërësi kërkesat e lartcekura. Nëse një veprim i tillë nuk bëhet atëherë ne këtë veprim të autoritetit kontraktues nuk mund ta kuptojmë ndryshe përveç se favorizim i hapur ndaj një OE të caktuar (të cilin AK-ja e din shumë mirë se për cilën kompani e kemi fjalën).

Kërkojmë që të largohen kërkesat e kontestuara më lartë, me qëllim që të hapet konkurrenca dhe të mos ketë favorizime në këtë aktivitet të prokurimit. Nëse nuk largohen / ndryshohet kërkesat e lartcekura, atëherë ne këto kërkesa nuk mund ti kuptojmë ndryshe përveç se favorizim të hapur ndaj një kompanie të caktuar. Njëkohësisht me këto kërkesa po ju pamundësohet ofertimi OE me shumë përvojë në fushën e renovimit dhe gjithashtu po diskriminohen edhe OE të themeluar rishtazi.

Ne me dt.15 prill 2024 kemi pranuar vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim, ku e njëjta është aprovuar si pjesërisht nga Spitali i Përgjithshëm Pejë.

Edhe pse autoriteti kontraktues në vendimin e saj për aprovim të pjesërishëm të kërkesës për rishqyrtim i ka marr parasysh dy pretendimet tona ankimore, ne jemi të detyruar të parashtrojmë këtë ankesë, pasi që pretendimet kryesore të cilat e kufizojnë konkurrencën në maksimum nuk janë marr parasysh.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues për pretendimet të cilat nuk janë marr parasysh është arsyetim i pa bazuar dhe i pa arsyetuar fare, mirëpo vetëm është cekur se kinse stafi dhe makineritë e kërkuara janë të nevojshme.

Në lidhje me pretendimin tonë ankimor sa i përket ISO certifikatave të kërkuara për OE ofertues, autoriteti kontraktues në arsyetimin e saj e ka cekur se kinse është aprovuar pretendimi jonë ankimor, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur. AK-ja e ka larguar nga dosja vetëm standardin EN- ISO 27001-2013, mirëpo jo edhe kërkesat për standardet EN- ISO 14001-2015; EN- ISO 45001-2018; për të cilat standarde ne e kemi sqaruar shumë qartë se të njëjtat janë të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit.
Andaj kërkojmë nga OSHP-ja të i analizoj në detaje pretendime tona dhe të nxjerrët një vendim meritor.

Gjithashtu sa i përket pretendimeve tona ankimore në lidhje me stafin profesional, menaxherin e kontratës dhe teknikët e kërkuar, autoriteti kontraktues e ka cekur si në vijim *"Refuzohet tërësisht pretendimi ankimor sa i përket Stafit profesional dhe Menaxherit të kontratës, pasiqë i gjithë stafi i kërkuar është i nevojshëm dhe i domosdoshëm që të jenë të kyçur në projekt, duke ju referuar paramses dhe parallogarisë, kemi të bëjmë me renovime dhe do të kryhen të gjitha punët, lyrerja, dyshemeja, shtrimi laminatit, shtrimi granitit, punët elektrike, inxhinierike, etj".*

Nga ky arsyetim i autoritetit kontraktues fillimisht pranohet se teknikët e kërkuar nuk janë të nevojshëm në këtë aktivitet të prokurimit, pasi që nuk janë përmendur fare në këtë arsyetim, ndërsa në lidhje me stafin profesional përkatësisht inxhinierët e kërkuar dhe lëminë e kërkuar për menaxherin e kontratës e njëjta nuk ka mundur ta arsyetoj fare. E njëjta vetëm e ka cekur se janë të nevojshëm, mirëpo në asnjë moment nuk ka mundur të dëshmoj të kundërtën e pretendimeve tona ankimore dhe ky fakt tregon qartë se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vendosur kërkesa diskriminuese për OE të interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht po e favorizon një OE të caktuar, të cilin AK-ja e di shumë mirë se për cilën kompani e kemi fjalën.

Të njëjtin arsyetim AK-ja e ka dhënë edhe për pajisjet e kërkuara për këtë aktivitet të prokurimit, mirëpo edhe pse ne e kemi sqaruar qartë se pajisjet e kontestuara nga ne janë të panevojshme dhe të pa arsyeshme për këtë aktivitet të prokurimit, e njëjta nuk e ka marr parasysh fare këtë fakt.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e disa prej pretendimeve tona ankimore, është i pa bazuar dhe njëkohësisht është vendim diskriminues i cili na pamundëson ofertimin jo vetëm neve si kompani e interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit, mirëpo edhe për shumë kompani tjera.

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*".
Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur.
Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit".*
Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se dosja e tenderit nuk është përpiluar në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk janë marr parasysh as neni 17.7 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që *"Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve".*
Pra duke u bazuar në të gjitha faktet që u cekën më lartë shihet tendenca për dhënien e kontratës operatorëve ekonomik të caktuar, pasi që gjitha kërkesat e lartpërmendura i përshtaten kompanive të caktuara dhe kufizohet konkurrenca.

Pra me këto kërkesa dhe dëshmi të kërkuara mundësia është shumë e madhe dhe pothuajse e pashmangshme e dëmtimit të buxhetit, sepse kompanitë e caktuara (favorizuese) mund të ofertojnë me çmime shumë më të larta dhe eventualisht të nënshkruajnë kontratë, prandaj mundësia e manipulimit me çmime kur përshtaten kërkesat është shumë e madhe.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në

nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj kërkesat të cilat i kontestuam më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, sepse aty shkruan qartë se *"Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike".*

Me këto kërkesa, jo vetëm që nuk i është kushtuar rëndësi operatorëve ekonomik të ri, por i është kufizuar konkurrenca edhe operatorëve ekonomik me përvojë dhe me stabilitet ekonomiko financiar dhe me aftësi teknike profesionale, prandaj duhet ndryshuar/larguar këto kërkesa që të mundësohet pjesëmarrje më e gjerë e operatorëve ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit dhe të merret parasysh edhe dispozita e lartpërmendur (25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik). Pra, në vend se të merret parasysh edhe zhvillimi i operatorëve ekonomik të rinjë, në këtë rast përveç se nuk është marr parasysh kjo dispozitë, janë diskriminuar hapur edhe operatorët ekonomik tjerë, me më shumë përvojë në këtë fushë siç është ky aktivitet i prokurimit. Pra është kufizuar konkurrenca.

Krejt në fund, kur kemi parasysh të gjitha faktet dhe dëshmitë që u përmendën më lartë dhe kërkesat favorizuese/diskriminuese, ju njoftojmë se nëse nuk ndryshohen këto kërkesa, ne nuk do të ndalemi me këtë ankesë por do të vazhdojmë procedurat ligjore edhe në institucionet tjera administrative por njëkohësisht më pastaj këto veprime dhe këto kërkesa do ti denoncojmë në organet tjera kompetente me qëllim që të njoftohen edhe institucionet tjera kompetente se në këtë rast ka kurdisje të plotë të këtij tenderi.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet faktike dhe ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"Valmir Loshi B.I."**

DETYROHET autoriteti kontraktues ti ndryshoj kërkesat, që u cekën më lartë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*